



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Numri i Çështjes	71023-03402-62-2018	Data e Regjistrimit	11/26/2018
Numri i Vendimit	62-2019-557	Data e Vendimit	2/11/2019

**VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS**

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER E PERBERE NGA:

KRYESUES: Igerta Hysi

ANËTAR

SEKRETARE Alketa Nushi

Objekti: Kerkesa per pushimin e ceshtjes

Baza Ligjore :

Përmbledhja e vendimit:

-

-

Për keto arsye:

-

<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office"

<?xml:namespace prefix = "v" ns = "urn:schemas-microsoft-com:vml"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER
RRETHI I FIER

Nr.Regj.Them.71023-03402-62-2018(1034)(189)
2019-557(140)

Nr.Vendimit 62-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Dt.Regj. 26.11.2018
01.02.2019

Dt. Vendimit

-
V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e përbërë nga :

GJYQTARE: Igerta HYSI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Alketa Semanjaku**, sot në datë 01.02.2019, mori në shqyrtim, në seancë paraprake, me dyer të mbyllura, kërkesën penale me Nr.Regjistri Themeltar 71023-03402-62-2018(1034) (189) që i përket,

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, përfaqësuar në gjykim nga prokurore, **Zj.Englantina Shehu**.

OBJEKTI :

Pushimin e proçedimit penal nr.664, datë 15.05.2015, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të personit nën hetim, shtetasit -----, atësia Zeni dhe amësia Florie, i datëlindjes 09.10.1973, lindur dhe banues në Kurjan Fier, me arsim të mesëm, i martuar, me shtetësi shqiptare, mbrojtur në gjykim nga mbrojtës i zgjedhur prej tij, **Av.Baftjar Shehu**, anëtar i Dhomës së Avokatisë Fier.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

BAZA LIGJORE:
K.Pr.Penale.

Nenet 328/1 gërma "b" dhe 329/a të

Në përfundim të seancës paraprake zhvilluar në prani të përfaqësueses të Prokurorisë, pa praninë e personit nën hetim, shtetasit ----- dhe në prani të mbrojtësit të tij Av.Baftjar Shehu, Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore, nënshtruar rregullave të gjykimit, si dhe pasi dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, në të cilën u kërkua:

Prokurorja: Pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale Nr.664, datë 15.05.2015, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Mbrojtësi i personi në hetim, shtetasi -----: Jemi dakort me prokuroren.

-
-

V Ë R E N:

-

I) Proçedura

-

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për pushimin e çështjes penale Nr.664, datë 15.05.2015, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit -----.

Në gjykimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes, sipas nenit 329/a paragrafi i katërt i K.Pr.Penale, kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e proçedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim, të cilët kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre.

Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, Gjykata në çështjen objekt gjykimi, vendosi të thërrasë në këtë proçes gjyqësor prokurorinë, personin nën hetim, shtetasit -----, të cilët janë subjekte që legjitimohen për të qënë pjesëmarrës në gjykimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

akuzës ose të çështjes, bazuar në nenin 329/a/4 dhe 329/b/1 të K.Pr.Penale.

II) Rrethanat e faktit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, në datën 15.05.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, mbi bazën e materialit referues të policisë gjyqësore, ka regjistruar procedimin penal Nr.664, në lidhje me veprën penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve -----, Eltjon Hyska dhe Kadri Hyska.

Me vendimin e datës 18.04.2016, nga ana e prokurorit është vendosur *“Pushimi i procedimit penal me nr.664/2015”*, me argumentin se fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kjo në mungesë të plotësimit të elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Me kërkesën e datës 19.01.2017, nga ana e prokurorit është kërkuar revokimi i vendimit të pushimit për procedimin penal me nr.664, të vitit 2015, për shtetasin -----, pas mbërritjes së letërporosisë nga autoritetet greke, sipas të cilës rezultonte se ky shtetas ishte me precedentë penal.

Me vendimin me nr.62-2018-312 (96), datë 25.01.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur *“Revokimin e vendimit të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, të datës 18.04.2016 “Pushimin e procedimit penal me nr.664, të vitit 2015” dhe rifillimin e hetimeve”*.

Vendimi i mësipërm është pasqyruar në regjistrin përkatës të procedimeve penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier më datë 05.02.2018.

Në përfundim të hetimeve të kryera për efekt të këtij procedimi penal ka rezultuar se:

Nga informacionet e disponuara nga ana e policisë gjyqësore në lidhje me shtetasit ----- Eltjon Hyska, Jorida Kurti dhe Gëzim Ramaj, ka rezultuar se shtetasit e sipërpërmendur janë pjesëtarë të një organizate kriminale në Greqi, ku si aktivitet kryesor kanë trafikimin e lëndëve narkotike, vjedhje automjesh dhe falsifikimin e dokumenteve.

Shtetasja Jorida Kurti është arrestuar ndërsa po largohej nga Greqia. Shtetasi ----- ndodhet i burgosur, ndërsa shtetasit Eltjon Hyska dhe Julian Ramaj janë larguar nga Greqia.

Nga verifikimet e kryera për shtetasin ----- ka rezultuar se, për periudhën 2009-2010 ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh që variojnë nga 5.000 lekë-4.431.465 lekë, nga 1.000 euro-31.950 euro.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Natyra e debitimeve dhe kreditimeve është e tipit , derdhje, tërheqje, komision, këmbim valutor, likuidime.

Për periudhën mars 2011-shkurt 2012 ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh që variojnë deri në shumën 30.000 lekë. Natyra e debitimeve dhe kreditimeve është e tipit derdhje, tërheqje komision, tatim në burim.

Më datën 21.03.2013 ka nënshkruar një kontratë shitblerjes, ku i shet shtetasit Demir Rami Ngjeqari një automjet me vlerën 11.000 euro.

Në emër të shtetasit -----, figuron një person fizik, me NIPT K63430405S, me objekt "*Konfeksione*", i regjistruar më datë 30.01.2006. Nga verifikimet e kryera për këtë biznes ka rezultuar se më datën 02.09.2009, ka tërhequr në emër të biznesit shumën prej 1.576.000 lekë.

Në vijim, në funksion të verifikimeve të kryera për efekt të këtij kallëzimi penal, nga ana e organit të prokurorisë i është kërkuar informacion në lidhje me pasuritë e luajtshme të paluajtshme të shtetasit ----- dhe familjarëve të tij, institucioneve private dhe shtetërore pranë të cilave figurojnë të regjistruar pasuritë e llojit të mësipërm.

Kështu, nga informacioni i marrë nga të gjitha bankat e nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri ka rezultuar se:

Në **Raiffeisen Bank**, shtetasi Zeni Hoxha, ka pasur llogari e cila është mbyllur, ndërsa shtetasi Kristo Qirici ka llogari me gjendje aktuale 375 euro;

Në bankën **Societe Generale Albania** shtetasi Zeni Hoxha ka pasur llogari e cila është mbyllur në vitin 2010; shtetasi -----, ka llogari rrjedhëse në monedhën euro me balancë 0 lekë;

Në **Abi Bankë**, shtetasi -----, ka llogari kursimi me balancë 32.168,89 lekë.

Në **BKT** shtetasit ----- dhe Kristo Qirici kanë pasur llogari bankare. Gjendja aktuale është 0 lekë dhe 0 euro.

Në bankën **Fibank, International Commercial Albania, etj**, shtetasi ----- dhe familjarët e tij nuk kanë pasur llogari bankare

Nga institucioni financiar **Union Financiar Tiranë** janë vënë në dispozicion të organit procedues të gjitha transfertat të realizuara nëpërmjet këtij shërbimi në favor të shtetasit Kristo Qirici. Nga këqyrja e transfertave të realizuara rezulton, se në total janë realizuar gjithsej 3 dërgues të shumës totale prej 1.050 euro.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Nga institucioni Financiar AK-Invest, është bërë me dije se shtetasi ----- dhe familjarët e tij nuk kanë kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit të AK-Invest sha.

Nga përgjigjet e ardhura nga të gjitha ZVRPP që operojnë në të gjithë territorin e Shqipërisë, ka rezultuar, se në emër të shtetasve objekt të këtij procedimi penal, nuk figurojnë të regjistruara pasuri, në asnjë prej 35 ZVRPP që operojnë në të gjithë vendin.

Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, me shkresën me nr.4080/1, datë 19.03.2018, është bërë me dije se, shtetasi -----, rezulton i regjistruar si person fizik me NIPT K63430405S, me aktivitet “ *tregti me pakicë e veshjeve*”, me adresë: Rockovec, me datë regjistrimi 30.10.2006, me status pasiv prej datës 26.09.2008; Shtetasi Zeni Hoxha, rezulton i regjistruar si fermer me NIPT L53513539H, me aktivitet “ *Prodhues Bujqësor*”; Shtetasja Florie Hoxha, ka qenë e regjistruar si person fizik me NIPTK82810401N, me aktivitet “ *tregtia me pakicë e veshjeve*”, me adresë Kurjan, regjistruar më datë 10.04.2008 dhe çrregjistruar prej datës 07.02.2014; Shtetasi Kristo Qirici , rezulton i regjistruar në DRT Sarandë, me NIPT L04230802J.

Me shkresën nr.3945/1 prot, datë 16.03.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ka bërë më dije shtetasi Edmond Zeni Papa dhe familjarët e tij, aktualisht nuk kanë në pronësi mjete.

Me shkresën me nr.4491/1 prot, datë 23.03.2018 OSHEE, ka bërë me dije se, me gjeneralitetet -----, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohen 15 abonent me kontratë furnizimi të energjisë elektrike me Operatorin e shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Me gjeneralitetet Zeni Hoxha identifikohen 11 abonent; me gjeneralitetet Florie Hoxha identifikohen 1 abonent në Durrës dhe me gjeneralitetet Kristo Qirici identifikohen 3 abonent. Bashkëlidhur janë vënë në dispozicion edhe fletët e printuar të sistemit. Nga këqyrja e këtyre të fundit rezulton se ato përmbajë të dhëna për numrin e kontratës dhe qytetin, ndërkohë që për abonentin rezulton vetëm emri dhe mbiemri dhe asnjë gjeneralitet tjetër.

Nga këqyrja e regjistrit themeltar të gjendjes civile, rezulton se me të dhënat ----- rezultojnë gjithsej 18 shtetas; me të dhënat Zeni Hoxha, rezultojnë gjithsej 9 shtetas; me të dhënat Florie Hoxha rezultojnë gjithsej 12 shtetas ndërsa më të dhënat Kristo Qirici rezultojnë gjithsej 8 shtetas.

Nga verifikimet e kryera nga Zyra e Interpolit, rezulton se shtetasi -----, nga verifikimet e kryera në databazën greke figuron me rekorde kriminale, për veprat penale “ *Zhvatje*” në vitin 1996, Drogë në vitin 1997 dhe Mashtrim në vitin 2013. Ky shtetas ka qenë i burgosur në 2013 dhe është dëbuar nga territori grek deri më 26.01.2037. Ndërkohë që nga këqyrja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

e regjistrit të gjendjes gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se shtetasi ----- dhe familjarët e tij, nuk figurojnë të dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale në Shqipëri.

Në vijim, me qëllim sqarimin e situatës së gjendjes bankare, lëvizjeve në llogaritë bankare, transaksioneve të kryera nga shtetasit që atribuohet vepra penale, nga ana e organit procedues është vendosur kryerja e ekspertimit kontabël. Nga akti i ekspertimit kontabël, i datës 26.02.2016, ka rezultuar se: ka vetëm transaksione marrëse nga Ak Invest në shumën 6000 euro. Të ardhura të tjera të deklaruara nuk ka. Që nga viti 2005 ka bërë derdhje në shuma të konsiderueshme në bankë në dollarë në shumën 61.000 \$, me përshkrim vetëm derdhje kesh. Gjatë viteve ka bërë dhe derdhje të tjera në shuma dhe monedha të ndryshme si: në vitin 2009-2013, ka derdhur dhe më pas ka tërhequr në BKT shumen prej 2.742.716 lekëve. Në vitet në vitin 2009-2013, ka derdhur dhe më pas ka tërhequr në BKT shumen prej 12.500 eurove. Në vitin 2010 ka derdhur në bankën Credit Agrikole shumën prej 4.400.000 lekëve dhe po këtë vit ka tërhequr shumën prej 4.431.465 lekëve. Në vitet 2005-2008 ka derdhur në Intesa Sapaolo Bank shumën prej 61.000 USD dhe po në këto vite ka tërhequr të njëjtën shumë. Në vitet 2005-2008 ka derdhur në Intesa Sapaolo Bank shumën prej 500 GBP dhe po në këto vit ka tërhequr të njëjtën shumë. Në vitet 2008-2015 ka derdhur në Intesa Sapaolo Bank shumën prej 8.185 euro dhe po në këto vite ka tërhequr shumën prej 7.850 euro. Në vitet 2005-2009 ka derdhur në Intesa Sanpaolo Bank shumën prej 93.777 euro dhe po në këto vite ka tërhequr të njëjtën shumë. Në vitet 2010-2015 ka derdhur në Societe General Bank shumën prej 22.900 euro dhe po në këto vite ka tërhequr shumën prej 22.869 eurove. Në vitet 2010-2015 ka derdhur në Societe General bank shumën prej 5.88.098 lekëve dhe po në këto vite ka tërhequr të njëjtën shumë. Në vitet 2011-2015 ka marrë kredi pranë Societe General Bank shumën prej 1.104.006 lekëve.

Për shumat e derdhura në bankë nuk ka dokumente dhe përshkrim në lidhje me burimin e të ardhurave. Ka në pronësi një automjet në emër të tij. Në vitin 2006 ka hapur një biznes në emër të tij si person fizik, por nuk ka bërë deklarime. Pasuri në emër të tij nuk ka të regjistruara.

Në vijim, në kuadër të hetimit të kësaj çështje është kërkuar nga autoriteti procedues, nëpërmjet letërpororsisë drejtuar autoriteteve të drejtësisë së shtetit Grek, marrja e vendimeve të dënimit për personat nën hetim.

Me shkresën me nr.3615/7, datë 08.01.2018 Ministria e Drejtësisë ka përcjellë materialet e ekzekutimit të letërpororsisë nga autoritetet e drejtësisë së shtetit Grek. Nga këqyrja e këtyre të fundit rezulton se, është dënuar nga Gjykata Kundravajtjeve më datë 25.05.2005, me 62 ditë burgim, i cili është



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

konvertuar me gjobë (nuk na është vënë në dispozicion kopja e vendimit). Ndërkohë që emër të shtetasit -----, figurojnë 4 akuza të lënë pezull (pezulluara) konkretisht në vitet 1996, 1999, 2012 dhe 2013. Gjithashtu, shtetasi ----- është arrestuar në shtetin Grek më datë 17.05.2013, për veprën penale blerje, posedim dhe shitje të lëndëve narkotike. Kjo çështje është pezulluar dhe nuk është dërguar për gjykim.

I pyetur në lidhje me faktet objekt të këtij procedimi penal shtetasi **Kadri Hyska** ka shpjeguar se, shtetasi Eltjo Hyska është djali i tij, ndërsa shtetasja Jorida Kurti është nusja e djalit. Gjatë periudhës 2000-2011, djali i tij ka jetuar dhe punuar në Greqi. Gjatë vitit 2011 djali i tij i ka dërguar para nga Greqia për disa probleme familjare që ai kishte. Këto para i ka dërguar nëpërmjet bashkëshortes së tij Joridës. Shtetasi Melsi Hyska është djali i vëllait. Ky i fundit i ka dërguar në vitin 2011 vëllait të tij para nëpërmjet tij. Shtetasit ----- dhe Gëzim Ramaj nuk i njeh.

Shtetasi **Kristo Qirici**, vëllai i personit nën hetim ka deklaruar se, gjeneralitetet i ka ndërruar për efekt dokumentacioni në Greqi, më parë quhej Jetmir Hoxha. Që nga viti 2009 ai jeton në qytetin e Sarandës. Në vitin 2010, ka marrë me qira një objekt, hotel, në vendin e quajtur kanali i Cukës, Sarandë, nga shtetasi Andon Sulo Hoxha. Deklaruesi tregon se, në fshatin Kurjan ai, prindërit dhe vëllai kanë vreshta dhe ullinj, nga të cilat sigurojnë të ardhura të mira. Ai nuk ka ndonjë pasuri të paluajtshme përveç shtëpisë në fshat që e ka së bashku me prindërit dhe vëllain.

Shtetasi **Kudret Gjoka**, ka deklaruar se, shtetasin -----, e njeh pasi janë nga i njëjti fshat dhe përveç kësaj kanë hyrje dhe dalje familjare. Në vitin 2011 ai i ka transferuar nëpërmjet shërbimeve Ëester Union këtij shtetasi shumë prej 6000 eurosh (tre herë nga 2000 euro). Këto para ai ia kishte marrë borxh Edmondit në vitin 2002 ose 2003, kohë kur Edmondi ka qenë emigrant në Angli. Shuma e lekëve i nevojitej për problemet e tij familjare. Në vitin 2011 ai ka mundur të sigurojë këto të ardhura dhe i ka kthyer Edmondit borxhin, duke ia dërguar me Ëester Union. Në atë kohë ai ka qenë emigrant në Greqi, ku ka kryer punë të ndryshme si në ndërtim, pastrim pallatesh, etj.

I pyetur si person nën hetim, shtetasi ----- ka deklaruar se, ai aktualisht jeton në Rumani, ku bashkëjeton që prej vitit 2011 me një shtetase rumune. Mbiemrin e mëparshme ka pasur Hoxha dhe e ka ndryshuar në vitin 2005 për efekt dokumentacioni në Greqi. Aktualisht është i punësuar në tokat e nënës së bashkëjetueses së tij, ku kryen punë të ndryshme në bujqësi. Që nga viti 1990 ai ka filluar emigracionin në Greqi, ku ka kryer punë të ndryshme në qytete të ndryshme. Deri në vitin 2000 ka jetuar dhe punuar në Greqi dhe nga viti 2000-2005 ka qenë emigrant në Londër, Angli pa dokumente. Në vitin 2005 i është refuzuar kërkesa e azilit dhe është larguar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

nga Anglia me dëshirën e tij. Në këtë shtetas ka jetuar me dy kushërinjtë e tij dhe ka punuar në ndërtim, në të zezë, ku merrte të ardhura 40.000-60.000 paund në vit. Qiranë e shtëpisë e paguante shteti pasi ishte regjistruar si azilant. Në vitin 2005 është kthyer në Shqipëri, ku ka qenë për pak kohë i papunë dhe gjatë periudhës 2006-2008 ka hapur një dyqan konfeksionesh në emrin e tij në Roskovec, i cili ka qenë dyqani i parë në atë kohë në Roskovec. Detyrimet i ka paguar të gjitha, por në atë kohë nuk ka qenë i detyrueshëm deklarimi i fitimit. Në atë kohë, biznesi i madh ndahej nga i vogli mbi bazën e sipërfaqes së objektit. Nga ky biznes ka siguruar të ardhura të mira që shkonin rreth 300.000 lekë në muaj. Në vitin 2008 e ka mbyllur biznesin dhe ka shkuar në Greqi, ku ka kryer punë të ndryshme. Në vitin 2012 është arrestuar në Greqi, ku është akuzuar për transport narkotikësh në rolin e shoqëruesit, ku ka bërë disa ditë paraburgim dhe nuk ka asnjë lloj dijenie se çfarë është bërë me këtë çështje. Në lidhje me hetimin e hapur në Greqi, në vitin 2005, deklaruesi ka treguar se bëhej fjalë për shoqërim refugjatësh të paligjshëm në territorin grek, ku ai është dënuar me gjobë. Në vitin 1996 është arrestuar padrejtësisht, pasi e akuzonin për rrëmbim personi. Kjo çështje nuk ka shkuar asnjëherë në gjykatë, sepse nuk kishte asnjë provë në ngarkim të tij. Kjo është e konfirmuar edhe nga shkresa nr.24 të autoriteteve greke që prokuroria disponon. Në lidhje me pagesën e kryer për llogari të tij nga shtetasi Kudret Gjoka, deklaruesi ka treguar se, këtë shumë ky shtetas ia kishte marrë borxh kur kishte qenë në Angli. Në lidhje me shumën prej 61.000USD të depozituar prej tij në Intesa Sanpaulo Bank, deklaruesi ka treguar se, ato janë kursimet e tij nga puna që ka kryer në emigracion në Angli. Ai ka pasur llogarit edhe në banka të tjera, ku shuma totale nuk i ka kaluar 80.000 eurosh. Burimi i këtyre parave ka qenë puna në Greqi, Angli dhe të ardhurat nga biznesi. Të gjitha këto llogari janë krijuar para vitit 2013, ku ai është arrestuar në Greqi. E gjithë shuma që ka qarkulluar është rreth 80.000 euro dhe kjo ka qarkulluar nëpër banka të ndryshme për shkak të marrjes së vizave për shtete të ndryshme si Gjermani, Spanjë, etj, sepse ka qenë kushti domosdoshëm garancia bankare për marrjen e vizave.

Duke u bazuar në rrethanat si më sipër, prokuroria ka arritur në përfundimin se, në rastin konkret jemi përpara situates, kur veprimet/mosveprimet e kryera nga ana e personit nën hetim -----, nuk parashikohen nga ligji si vepër penale.

Për këto arsye, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 20.07.2018 i është drejtuar Gjykatës me kërkesë "Për pushimin e çështjes penale nr.664/2015 për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të shtetasit -----, bazuar në nenet 328/1 germa "b" dhe 329/a të K.Pr.Penale (ndryshuar me ligjin nr.35/2017).

Në lidhje me këtë kërkesë të prokurorisë, mbrojtësi dhe personi nën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

hetim ish-in dakort.

Me vendimin nr.62-2018-4707(658), datë 25.09.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur:

1. *“Rrëzimin e kërkesës.*
2. *Kthimin e akteve të procedimit penal Nr. 664, datë 15.05.2015, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke urdhëruar kryerjen e hetimeve sipas drejtimeve të përshkruara në pjesën arsyetuese të vendimit.*
3. *Urdhërimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që të përfundojë hetimet brenda një afati prej 2 (dy) muaji nga dita që ky vendim do të marrë formë të prerë.*
4. *Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.*
5. *Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.*
6. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.”*

Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 11.10.2018, pa u ankimuar nga palët.

Në përmbatje të vendimit të mësipërm, gjykata ka arsyetuar se *“ Në rastin konkret, gjykata çmon se nga ana e organit të prokurorisë nuk është hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme në lidhje me pasuritë që figurojnë në emër të familjarëve të personit nën hetim. Më konkretisht, gjykata vlerëson se, nga ana e prokurorisë duhet të ishte kryer një hetim më i thelluar në lidhje me objektin hotel, në vendin e quajtur kanali i Çukës, për të cilin shtetasi Kristo Qirici (vëllai i personit nën hetim) ka deklaruar se e ka marrë me qira në vitin 2010, nga shtetasi Andon Sulo Hoxha. Gjykata vlerëson se, pavarësisht se ekziston një akt noterial për dhënien më qira të këtij objekti shtetasit kristo Qirici nga shtetasi Andon Sulo Hoxha, prokuroria duhet të kryejë hetime në drejtim të krijimit të kësaj pasurie nga ana e këtij të fundit”.*

Në vijim, në zbatim të urdhërimit të gjykatës, nga ana e organit procedues, është administruar nëpërmjet shkresës me nr.10347/1 prot, datë 01.11.2018, të ZVRPP Sarandë, e gjithë praktika e regjistrimit të pasurisë Hotel, në pronësi të shtetasit Andon Sulo Hoxha.

Nga këqyrja e kësaj të fundit rezulton se, sipas vërtetimit hipotekor nr.1, fq 50, nr.247 ikd, datë 23.10.2008, rezulton se në emrin Andon Sulo Hoxha,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

figuron e rregjistruar një objekt *“Hotel me sipërfaqe ndërtimi prej 160 m2. Objekti është tre katësh, kati i parë shërben si lokal, kati i dytë dhe i tretë si hotel.*

Mbi bazën e lejes së ndërtimit me nr.3/14, datë 18.10.2010, KRRT e Bashkisë Sarandë ka miratuar ndërtimin e *“Lokal dhe hotel”, shtesë kati dhe dalje në taracë, të financuar nga shtetasi Andon .S.Hoxha”.*

Me kontratën e datës 13.2016, me nr.956 rep, nr.417/1 kol, shtetasi Andon Sulo, ka blerë nga shtetasi Shyqyri Kalemi, truallin me sipërfaqe 400 m2 (trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti), për të cilin është pajisur me certifikatë pronësie më datë 13.04.2016.

Në funksion të kryerjes së urdhërimeve të gjykatës, nga ana organit të akuzës është kërkuar të pyetet edhe shtetasi Andon Hoxha. Sipas informacionit të oficerit të policisë gjyqësore të datës 19.10.2018, rezulton se shtetasi Andon Hoxha është larguar nga PKK Kakavijë më datë 22.09.2018.

Në përfundim të hetimeve të kryera si më sipër, prokuroria ka arritur në përfundimin se, edhe pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga ana e Gjykatës, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë e re, për të arritur në një konkluzion të ndryshëm nga kërkimi i parë.

Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 26.11.2018, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë *“Për pushimin e çështjes penale nr.664/2015 për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të shtetasit -----, bazuar në nenet 328/1 germa “b” dhe 329/a të K.Pr.Penale (ndryshuar me ligjin nr.35/2017).*

Në lidhje me këtë kërkesë të prokurorisë, ishte dakort edhe mbrojtësi i personit nën hetim.

III) Vlerësimi i Gjykatës.

Neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit”.* Nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror. Ky detyrim i shtetit rrjedh nga fakti se ai është garanti i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kriterëve të përcaktuara qartë dhe në mënyrë sa më të detajuar.

Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm që ndihmon në dhënien e drejtësisë penale. Ky organ i specializuar ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Ligji procedural penal parashikon të gjitha fazat e hetimit paraprak që duhet të kryhen nga prokuroria, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrëjë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari. Akuza është procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

Gjithashtu, në nenin 291 dhe 329 të K.Pr.Penale, është parashikuar e drejta e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal (në rastin e kundravajtjeve penale). Ky kontroll ushtrohet në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të. Kjo e drejtë për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur dhe paanshëm, është në përputhje edhe me standartet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Ndërsa në nenin 329/a të K.Pr.Penale sanksionohet se në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328 të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes. **Gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes, duhet të konstatojë, nëse kërkesa e prokurorit është në zbatim të ligjit dhe e mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.**

Referuar kompetencës së mësipërme të parashikuar në ligj, organi i prokurorisë ka paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake një kërkesë me objekt pushimin e procedimit penal Nr. 664 të vitit 2015, me arsyetimin se ndodhemi në kushtet e parashikimit të nenit 328 pika "b" e K.Pr.Penale.

Në nenin 328 pika "b" e K.Pr.Penale parashikohet shprehimisht se: *"Në përfundim të hetimeve paraprake... prokurori procedon me pushimin e*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

akuzës ose çështjes kur: b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”. Kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë sistematike me nenin 329/a të K.Pr.Penale, sipas të cilit parashikohet shprehimisht se: “Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328 i këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake të vendosë pushimin e akuzës ose çështjes penale”.

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata çmon të trajtojë paraprakisht elementët e figurës së veprës penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, për të konkluduar më pas nëse veprimet hetimore të kryera nga prokuroria në funksion të zbardhjes së kësaj figure të veprës penale janë apo jo të plota e të gjithëanshme. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se:

“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”

Nga interpretimi i fakteve të parashtruara më lart, nën dritën e dispozitës së mësipërme Gjykata arrin në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar interesat shtetërorë nga pastrimi i produkteve të veprës penale në formë të ndryshme, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

Kështu, në lidhje me faktin se *“çfarë do të quajmë produkt të veprës penale”* në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal, i referohemi së pari neni 1 të Konventës së Këshillit të Evropës *“Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit”. Ky i fundit jep këtë përkufizim: “Për qëllime të kësaj Konvente: a) “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nën paragrafin b të këtij neni; b) “pasuri” nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;”

Nocionin e “produktit të veprës penale” e gjejmë në nenin 36 të Kodit Penal, i cili parashikon se: “1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale; b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;”. Parashikimi i nenit 36 të Kodit Penal në lidhje me nocionin e “produktit të veprës penale” është i ngjashëm me atë të nenit 1 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit”, që do të thotë se, produkt të veprës penale, do të kuptojmë çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga një vepër penale, i cili mund të konsistojë në pasuri të çdo natyre si dhe në dokumente apo akte juridike që vërtetojnë një titull apo një interes mbi këtë pasuri.

Cenimi i kesaj marredhenieje nga shtetasit, pavaresisht nga shkaqet, perben krim dhe passjell pergjegjesi penale. Në mënyrë që shkelja e kësaj dispozite të cilësohet nga ligji si vepër penale duhet që:

Se pari, personi te kete qene i denuar per nje fakt penal qe parashikohet nga Kodi Penal ose dhe pse nuk ka qene i denuar, te kete te dhena te mjaftueshme qe te krijojne bindjen se ai eshte marre ose merret me veprimtari kriminale edhe pse vepra penale, produktet e se ciles pastrohen, eshte kryer nga nje person qe nuk mund te merret si i pandehur ose qe nuk mund te denohet, ndjekja penale per vepren, produktet e se ciles pastrohen eshte parashkruar ose amnistuar, personi qe kryen pastrimin e produkteve eshte i njejte me personin qe ka kryer vepren, nga e cila kane rrjedhur produktet.

Se dyti, duhet te vertetohet dhe provohet se, personat e lidhur qofte ne lidhje gjaku ose jo kryejne nje nga keto veprime me pasurite qe rrjedhin nga veprimtari kriminale, duke kryer kembim ose transferimi te pasurise, me qellim fshehjen ose mbulimin e origjines se paligjshme te saj, duke ditur se kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; fshehjes ose mbulimit te natyres se vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronesise ose te drejtave ne lidhje me pasurine,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

duke ditur qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; fitimit te pronesise, posedimit ose perdorimit te pasurise, duke e ditur ne castin e marrjes ne dorezim te saj, qe kjo pasuri eshte produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale; kryerjes se veprimeve financiare ose transaksioneve te copezuara per shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit per parandalimin e pastrimit te parave; investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave a sendeve, duke ditur se jane produkte te vepres penale ose veprimtarise kriminale.

Se treti, te gjitha keto veprime te kryera vec e vec ose bashkarisht me pasurine qe rrjedh nga veprimtaria kriminale, kryhen gjithmone me dashje dhe me paramendim nga subjekti, pasi ai e di qe keto te ardhura ose interesa pasurore rrjedhin nga veprimtaria kriminale e nje personi te caktuar dhe me dashje e fsheh, transferon, tjeterson, copezon, kemben në te tjera forma ate. Pra duhet qe ne cdo rast te provohet dhe qellimi posacem qe ka pasur subjekti qe i kryen keto veprime. Qëllimi është element cilësues i dispozitës konkrete dhe ai konsiston në: a) fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale. b) shmangia nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave. Pra, autori i veprës penale, veprimtarinë e tij kriminale e kryen duke e ditur që avantazhet apo pasuria që ai disponon janë produkt i veprës penale dhe synon t'i pastrojë ato, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm. Pastrimi i produkteve të veprës penale nuk përfaqëson një akt të vetëm, por përfshin një proces, i cili synon jo vetëm fshehjen e origjinës së vetë produktit, por edhe mbajtjen nën kontroll të tij.

Nga analizimi i akteve që i përkasin këtij procedimi penal me përcaktimet ligjore të sanksionuara në nenin 287 të K.Penal, gjykata vlerëson, se përfundimi i arritur nga ana e organit të akuzës se, në rastin konkret, fakti penal nuk parashikohet nga ligji si vepër penale është i bazuar në ligj dhe në prova.

Në rastin konkret, objekt të këtij procedimi penal, nga provat e administruara, rezulton se personi nën hetim -----, edhe pse rezulton i dënuar nga autoritet greke të drejtësisë, ai nuk disponon asnjë pasuri. Qoftë kjo e luajtshme, e paluajtshme apo në formën e një të drejtë. I njëjti fakt konstatohet edhe për personat e lidhur me të.

Fakti që personi nën hetim gjatë viteve 2009-2013, ka qarkulluar në sistemin bankar shumë rreth 80.000 euro, nuk do të thotë, nga ana e këtij të fundit është konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 287 e Kodit Penal. Kjo për sa kohë, që nga hetimi i kryer nuk rezulton se, këto të fundit të jenë bërë me qëllim fshehjen e origjinës së tyre, përzierjen e saj me para të ligjshme apo tjetërsimin e saj nga pasuri e luajtshme në të paluajtshme. Në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

kushtet kur këto para (të cilat nuk provohen se kanë qenë produkt i veprës penale) nuk janë investuar, nuk janë tjetërsuar apo bashkuar me para të ligjshme, nuk u kanë kaluar personave të tretë, sjellë mungesën e elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit penal, pasi:

Së pari, kemi mungesë të objektit material të veprës penale. Mungon vetë produkti i pastruar. Siç kemi evidentuar personi nën hetim dhe familjarët e tij nuk kanë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të regjistruar. Me qëllim verifikimin e këtij elementi, Gjykata, me vendimin nr.62-2018-4707(658), datë 25.09.2018, urdhëroi organin e akuzës për të kryer një hetim më të plotë në këtë drejtim, duke verifikuar edhe mënyrën e krijimit të pasurisë “hotel”, në vendin e quajtur kanali i Çukës, për të cilin shtetasi Kristo Qirici (vëllai i personit nën hetim) ka deklaruar se e ka marrë me qira në vitin 2010, nga shtetasi Andon Sulo Hoxha. Në vijim të hetimeve, nga këqyrja e praktikës së regjistrimit të kësaj pasurie rezulton se, sipas vërtetimit hipotekor nr.1, fq 50, nr.247 ikd, datë 23.10.2008, në emrin Andon Sulo Hoxha, figuron e rregjistruar një objekt “Hotel me sipërfaqe ndërtimi prej 160 m2. Objekti është tre katësh, kati i parë shërben si lokal, kati i dytë dhe i tretë si hotel. Mbi bazën e lejes së ndërtimit me nr.3/14, datë 18.10.2010, KRRT e Bashkisë Sarandë ka miratuar ndërtimin e “Lokal dhe hotel”, shtesë kati dhe dalje në taracë, të financuar nga shtetasi Andon .S.Hoxha”. Me kontratën e datës 13.2016, me nr.956 rep, nr.417/1 kol, shtetasi Andon Sulo, ka blerë nga shtetasi Shyqyri Kalemi, truallin me sipërfaqe 400 m2 (trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti), për të cilin është pajisur me çertifikatë pronësie më datë 13.04.2016. Pra, edhe pas kryerjes së këtyre veprimeve shtesë nuk rezultoi asnjë e dhënë që të lidhte personin nën hetim apo personat e lidhur me të me krijimin e kësaj pasurie.

Së dyti, në rastin konkret mungon ana objektive e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Nga analizimi i provave të administruara nuk rezulton se personi nën hetim të ketë kryer dhe realizuar tjetërsim, shkëmbim, transferim, etj të parave të pista/pasurive me qëllim fshehjen e origjinës së tyre, përzierjen me pasuri/para të ligjshme dhe investimin apo tjetërsimin e tyre. Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është ndryshimi, kthimi në një gjë tjetër; zëvendësimi ose transferimi i një të drejte nga një person në tjetrin. Qëllimi i sjelljes së tillë është për të transformuar një pjesë të pronës në një tjetër, me synim për ta bërë atë legjitime, në mënyrë që prona e paligjshme të fillojë të bëhet e ligjshme. Në rastin konkret, këto veprime dhe sjellje mungojnë.

Në përfundim, gjykata vlerëson se, në rastin konkret nuk provohet në mënyrë kumulative ekzistenca e elementëve objektive dhe subjektivë të veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Bazuar sa më sipër, duke analizuar përcaktimet e mësipërme ligjore me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

rrethanat faktike të rastit në shqyrtim, Gjykata çmon se, kërkesa e Prokurorisë së Rrethi Gjyqësor Fier “Për pushimin e çështjes penale nr.664, të vitit 2015”, është e drejtë dhe e bazuar në ligj, për rrjedhojë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

-

Gjykata, bazuar në nenet 328/1 gërma “b” dhe 329/a dhe 329/b/3 të Kodit të Proçedurës Penale,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor *****.
2. Pushimin e proçedimit penal nr.664, datë 15.05.2015, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit -----.
3. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi. Për personin nën hetim -----, në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të tij.

U shpall në Fier, sot më datë 01.02.2019

SEKRETARE
GJYQTARE
Semanjaku
HYSI

Alketa
Igerta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

Ky dokument është marrë nga www.gjkata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.